

Karakteristikat e mjeteve rrugore

Viti 2019

Tiranë më 30 Dhjetor 2020: Në botimin “Karakteristikat e mjeteve rrugore”, botuar për herë të parë nga INSTAT, jepet informacion mbi numrin e mjeteve rrugore që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me status “aktiv” ose “të çregjistruara përkohësisht” në Regjistrin Kombëtar Shqiptar të mjeteve rrugore. Të dhënat i referohen vitit 2019.

Numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "Aktiv" dhe "Të çregjistruar përkohësisht" rezulton 628.937 mjete.

Mjetet rrugore sipas llojit

Mjetet rrugore sipas llojit që zënë përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore rezultojnë “Autoveturat” (79,5 %), “Automjetet për transport të përzier” (7,1 %) dhe “Motomjetet” (6,0 %), (shih tab.1).

Tab. 1: Mjetet rrugore sipas llojit, 2019


Nr	Lloji	Numri i mjeteve
	Gjithsej	628.937
1.	Autovetura	499.779
2.	Automjete për transport të përzier	44.679
3.	Motomjete	37.954
4.	Kamion	13.538
5.	Rimorkio	8.712
6.	Automjete për transport të veçantë	6.435
7.	Autobuzë	7.500
8.	Të tjera	4.639
9.	Automjete për përdorim të veçantë	3.554
10.	Makina bujqësore	1.293
11.	Makina teknologjike	786
12.	Kamping	64
13.	Mjete rrugore të veçanta	4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Autovetura sipas markës

Numri gjithsej i autoveturave rezulton 499.779. Ndër markat kryesore të autoveturave që qarkullojnë në vend, dominojnë Mercedes Benz (30,7%), e ndjekur nga Volkswagen (16,6%) dhe Ford (10,0 %) të cilat paraqiten më të detajuara në figurën 1.

Fig.1 Autovetura sipas markës së mjetit, 2019 Fig. 2 Autovetura të grupuara sipas viteve të prodhimit, 2019



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Autovetura sipas vitit të prodhimit

Autoveturat e prodhuara gjatë periudhës kohore 2011-2019, zënë 7,4 % ndaj numrit gjithsej të autoveturave të regjistruara në vend, autoveturat e prodhuara gjatë periudhës kohore 2000-2010 zënë 64,4 % dhe autoveturat e prodhuara para vitit 2000, përbëjnë 28,2 %, figura 2.

Sipas detajimit të markave, markat më të përhapura të autoveturave, të prodhuara gjatë periudhës 2011-2019, janë "Mercedes Benz" (19,1 %), "Volkswagen" (14,1 %), Ford (7,7 %) dhe Audi (7,1%).

Referuar periudhës së prodhimit 2000-2010, markat më të përhapura janë "Mercedes Benz" (37,0 %), "Volkswagen" (16,5 %), "Ford" (11,3 %) dhe "Opel" (5,9%).

Për autoveturat e prodhuara para vitit 2000, markat më të përhapura rezultojnë "Mercedes Benz" (42,1 %), "Volkswagen" (17,5 %), "Ford" (7,6 %) dhe "Opel" (5,8 %).

Vihet re se tre janë markat të cilat janë në përdorim në vendin tonë, sipas periudhës së prodhimit deri në vitin 2019: "Mercedes Benz", "Volkswagen" dhe "Ford".

Autovetura sipas lëndës djegëse

Numri më i madh i autoveturave që qarkullojnë në vendin tonë përdorin lëndën djegëse “Naftë” (73,3 %), ndjekur nga autoveturat që përdorin lëndën djegëse “Benzinë” (19,4 %) dhe mjeteve që përdorin lëndë djegëse të kombinuar “Benzinë dhe Gaz” (7,1 %).

Vetëm 0,2 % e mjeteve përdorin lëndë djegëse si “Naftë, “Benzinë” ose “Gaz” të kombinuara me “Energjinë Elektrike”. Në figurën 3, paraqiten autoveturat sipas lëndës djegëse.

Fig. 3 Autovetura sipas lëndës djegëse, 2019





Fig. 4 Autoveturat sipas vëllimit të motorit, 2019



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Analizuar sipas periudhës së prodhimit, për autoveturat e prodhuara gjatë periudhës 2011-2019, 73,2 % e autoveturave përdorin lëndën djegëse “Naftë”, 21,0 % përdorin lëndën djegëse “Benzinë” dhe 4,3 % përdorin lëndët djegëse “Benzinë dhe Gaz”. Gjatë kësaj periudhe, 1,3 % e autoveturave mund të përdorin lëndën djegëse “Naftë”, “Benzinë” ose “Gaz” të kombinuara me “Energji Elektrike”.

Për autoveturat e prodhuara gjatë periudhës 2000-2010, vihet re se 76,1 % përdorin lëndën djegëse “Naftë”, 15,8 % përdorin “Benzinë” dhe 8,0 % përdorin “Benzinë dhe Gaz”.

Për autoveturat e prodhuara para vitit 2000, 67,0 % përdorin lëndën djegëse “Naftë”, 27,3 % përdorin “Benzinë” dhe 5,7 % përdorin “Benzinë dhe Gaz”.

Autovetura sipas Vëllimit të motorit

Sipas vëllimit të motorit, numri më i lartë i autoveturave ka një fuqi motorike deri në 2000 centimetra në kub duke zënë 66,8 %, të ndjekura nga autoveturat me vëllim 2001-3000 centimetra në kub me 30,6 % dhe autoveturat që kanë vëllim motorik më të madh se 3000 centimetra në kub me 2,6 %, figura 4.

Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është paraqitja e treguesve mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor në nivel sa më të detajuar si: mjetet rrugore sipas llojit, autoveturat sipas markës, autoveturat sipas vitit të prodhimit, autoveturat sipas lëndës djegëse dhe autoveturat sipas vëllimit motorik.

Në detajimin e mjeteve rrugore sipas llojit të mjeteve, kategoria “të tjera” përfshin llojet autovinç, MNT, MPV, MRV, MTP, MTV dhe tërheqës.

Në detajimin e autoveturave sipas lëndës djegëse, në grupin “të tjera” janë përfshirë kategoritë “Benzinë dhe Elektrike”, “Elektrike”, “Gaz”, “Naftë dhe Elektrike”, “Benzinë, Gaz dhe Elektrike” dhe “Naftë dhe Gaz”.

Në kategorinë “Motomjete” përfshihen: motor, motorr me kosh, motokarro, autokarro dhe ciklomotorr.

Përkufizime

Automjete për transport të përzier (ATP) - përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjësë, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Mjete rrugore të veçanta (MRV) - mjet rrugore të veçanta për karakteristikat e tyre të veçanta të përcaktuar si të tilla në Kodin Rrugor.

CC- njësia matëse e vëllimit motorik të mjeteve rrugore e shprehur në centimetra në kub.